

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË "WASSER" SH.P.K**

Ortakët themelues të poshtë shënuar:

- **Salion Duka**, i biri i Shuaip-it, i datëlindjes 15.09.1987, lindur në Borsh dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 034890809 / Nr. Personal I70915058J;
- **Istin Duka**, i biri i Shuaip-it, i datëlindjes 21.06.1990, lindur në Borsh dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 031930531 / Nr. Personal J00621060N;

.... themelojnë, sot, më 14 janar 2021, në Tiranë, në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, të quajtur "**WASSER**" sh.p.k.

### **1. Emërtimi**

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është: **SHOQËRIA "WASSER" SH.P.K.**

### **2. Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga "Thoma Koxhaj", Kompleksi "ARBJON-AZ", Kati 0, Yzberisht, Tiranë, Shqipëri.

### **3. Objekti i Shoqërisë**

3.1 Shoqëria "WASSER" sh.p.k do të ushtrojë veprimtarinë e vetë tregtare në fushën:

*"Import, eksport dhe tregtim i materialeve të ndërtimit me shumicë dhe pakicë, ku përfshihen materialet hidraulike, hidrosanitare, sistemet e ngrohjes dhe ftoshjes, rakorderite, etj."*

3.2 Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet tjeter nevojshëm ose të dobishëm për përbushjen e objektit të saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3.3 Shoqëria mund të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me kompani apo persona fizik që operojnë në fushën e saj apo fusha të tjera.

3.4 Shoqëria do të ofrojë shërbime për persona fizik dhe juridik, privat apo shtetëror, vendas apo të huaj.

### **4. Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

### **5. Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 1,000,000.00 (një milion lekë shqiptare);

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) Kuota të nënshkruara dhe që do të shlyhen nga ortakët themelues tërësisht në të holla. Në marrëveshje mes ortakëve, Kapitali i Shoqërisë mund të shlyhet edhe në natyrë. Në këtë rast, marrëveshja e Ortakëve do të përcaktojë vlerën në para të kontributit në natyrë të secilit Ortak.

  
1

## **6. Kontributet**

6.1 Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar, ndahet si më poshtë:

- **Istin Duka**, zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë të kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë ALL 500,000.00 (pesë qind mijë lekë shqiptare);
- **Salion Duka**, zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë të kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë ALL 500,000.00 (pesë qind mijë lekë shqiptare);

6.2 Sipas kontributeve, zotërimi i kuotave të Shoqërisë pasqyrohet si më poshtë vijon:

- **Istin Duka**, zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të vlerës së kapitalit fillestar të Shoqërisë;
- **Salion Duka**, zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të vlerës së kapitalit fillestar të Shoqërisë;

## **7. Transferimi i kuotave**

7.1 Kuotat e kapitalit themeltar të Shoqërisë i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

## **8. Organizimi, Organet Vendimmarrëse dhe Administruese të Shoqërisë**

8.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

8.2 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë. Nëpërmjet këtij Akti Themelues, emërohet si Administrator i parë i Shoqërisë për një afat 5 (pesë) vjeçar shtetasi si më poshtë:


- **Istin Duka**, i biri i Shuaip-it, i datëlindjes 21.06.1990, lindur në Borsh dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i "letërnjoftimit" (ID) Nr. 031930531 / Nr. Personal J00621060N;

8.3 Mënyra e detajuar e organizimit, kompetencat e organeve drejtuese të Shoqërisë, marrëdhëniet midis ortakëve dhe marrëdhëniet e Shoqërisë me subjektet e tjera të së drejtës, përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

## **9. Kopjet**

9.1 Ky Akt Themelimi është bërë në 2 (dy) kopje autentike me vlerë të njëjtë ligjore secila.

## **ORTAKËT THEMELUES**



2